



BASHKIA  
TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE JASHTË  
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT  
SEKTORI I OPINIONEVE QYTETARE

Raport përmblendhës i sondazhit

## Perceptimi qytetar për punën e Bashkisë Tiranë për vitin e fundit (2019-2020)



Gusht, 2020

<i>Grafiku 1. Pyetësorët sipas njësive administrative dhe lagjeve .....</i>	<i>5</i>
<i>Grafiku 2. Gjinia      Grafiku 3. Grup-mosha (vjeç).....</i>	<i>6</i>
<i>Grafiku 4. Informimi dhe transparenca mbi punët e Bashkisë Tiranë .....</i>	<i>6</i>
<i>Grafiku 5. Shërbimet sociale .....</i>	<i>7</i>
<i>Grafiku 6. Infrastruktura në institucionet e sistemit paraarsimor dhe arsimor .....</i>	<i>7</i>
<i>Grafiku 7. Investimet në infrastrukturë.....</i>	<i>8</i>
<i>Grafiku 8. Shërbimi i furnizimit me ujë.....</i>	<i>8</i>
<i>Grafiku 9. Trafiku dhe lëvizshmëria .....</i>	<i>9</i>
<i>Grafiku 10. Parkimet publike .....</i>	<i>9</i>
<i>Grafiku 11. Transporti urban.....</i>	<i>10</i>
<i>Grafiku 12. Menaxhimi i mbetjeve urbane .....</i>	<i>10</i>
<i>Grafiku 13. Pastrimi i hapësirave publike .....</i>	<i>11</i>
<i>Grafiku 14. Hapësirat rekreative dhe këndet e lojrave .....</i>	<i>11</i>
<i>Grafiku 15. Bashkëpronësia .....</i>	<i>12</i>
<i>Grafiku 16. Tregjet ushqimore .....</i>	<i>12</i>
<i>Grafiku 17. Promovimi i qytetit.....</i>	<i>13</i>
<i>Grafiku 18. Programet e rindërtimit pas 2 tërmeteve të vitit 2019.....</i>	<i>13</i>
<i>Grafiku 19. Menaxhimi i situatës Covid-19.....</i>	<i>14</i>
<i>Grafiku 20. Mbrojtja e territorit.....</i>	<i>14</i>
<i>Grafiku 21. Menaxhimi i situatës Covid-19.....</i>	<i>15</i>
<i>Grafiku 22. Ndriçimi publik .....</i>	<i>15</i>

## Hyrje

Bashkia e Tiranës i jep përparësi thelbësore konsultimit dhe vlerësimit për sa i përket projekteve, investimeve dhe shërbimeve që ky institucion garanton ndaj qytetarëve të kryeqytetit. Vjelja e opinioneve ofron një pasqyrë të vlefshme se sa bashkia i është përgjigjur nevojave qytetare si edhe shërben për të lexuar punën e bërë dhe njëkohësisht nxit përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve.

Me rikonfirmimin e kryetarit të bashkisë në zgjedhjet e vitit 2019, vazhdoi puna bazuar në strategjinë 5 vjeçare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë, ku parashikohen 5 qëllimet kryesore të zhvillimit:

1. Përmirësimi i infrastrukturës urbane
2. Arsimi për të gjithë
3. Zhvillimi i Ekonomisë Green
4. Tirana për të gjithë
5. Qeverisja e mirë

Viti 2019-2020 ka qënë një vit sfidash, dinamik dhe po ashtu shumë solidar për kryeqytetin dhe banorët e saj. Tirana sot numëron një sërë veprash në punë dhe veprimtari ku përmenden zgjerimi i impiantit të Bovillës, urbanizimi i zonave periferike, puna në “kantieret e dijes” ku përmendet përfundimi i shkollës Servete Maçi, këndet e lojrave, rikonceptimi i parkut Rinia, përfundimi i punimeve në lotin e 3-të të bulevardit verior, bulevardi Migjeni, logo e re me rastin e 100 vjetorit të Tiranës kryeqytet, monitorimi i cilësisë së ajrit nga aplikacioni Tirana ime etj. Zhvillime të tilla kanë rritur cilësinë e jetës dhe gjithashtu rrisin vlerën e pronës dhe biznesit.

Pas ngjarjes së tërmeteve të vitit 2019, Tirana u shndërrua në shtëpinë pritëse për familjet e prekura, shumë prej tyre u trajtuan me programet sociale, vazhdon rindërtimi i banesave të prekura nga tërmeti si dhe ka nisur puna për procesin e projekimit dhe ndërtimit për lagjet e reja në Kombinat, Shkozë, rruga 5 Maji.

Kushtet sfiduese të pandemisë rikujtuan se prioritet duhet të jenë investimet në gjelbërim, hapësira çlodhëse, trotuare për këmbësorët dhe korsi të dedikuara për biçikleta.

Falë punëve transformuese Tirana sot është një realitet në formim e sipër dhe ka një “album veprash urbane” për të cilat është vlerësuar dhe me çmime ndërkombëtare.

## **Qëllimi dhe objektivat e sondazhit**

**Qëllimi:** Evidentimi i opinionit qytetar lidhur me punët dhe veprimtarinë e Bashkisë së Tiranës në të gjitha fushat përgjatë vitit të fundit (2019 – 2020).

### **Objektivat - Vlerësimi i qytetarëve për:**

- Shërbimet e ofruara pranë sporteve të BT dh Nj.A, transparenca në lidhje me veprimtarinë e Bashkisë dhe programet e shërbimeve sociale;
- Infrastrukturën në çerdhe, kopshte, shkolla, atë rrugore dhe projekte të ndryshme, ndriçimin publik si edhe shërbimin e furnizimit me ujë;
- Trafikun dhe lëvizshmërinë, parkimet publike dhe transportin urban;
- Menaxhimin e mbetjeve urbane dhe pastrimin e hapësirave publike;
- Hapësirat rekreative, këndet e lojrave dhe nismat për objektet në bashkëpronësi;
- Tregjet ushqimore dhe promovimin e qytetit si aktivitete, panairë, festa etj;
- Programet e rindërtimit pas tërmeteve dhe menaxhimin e situatës së covid-19;
- Mbrojtjen e territorit, lirin e hapësirave dhe sigurimi i qetësisë publike.


## REZULTATET KRYESORE TË SONDAZHIT

Nëpërmjet grafikëve, ky raport pasqyron rezultatet kryesore në total të sondazhit, ku secili zë i grafikëve të mëposhtëm shënon të dhënat në total të të gjitha intervistave të kryera, gjatë procesit të vjeljes së mendimit qytetar.

Në këtë sondazh, sipas qëllimit dhe objektivave të tij, u evidentuan çështjet e mëposhtme:


### Të dhëna mbi demografinë<sup>1</sup>

*Grafiku 1. Pyetësorët e plotësuar në secilën njësi administrative dhe lagje*




<sup>1</sup> Numri i pyetësorëve për secilën njësi dhe lagje ndodhet në ankesin 2


Grafiku 2. Gjinia




Grafiku 3. Grup-mosha (vjeç)




Grafiku 4. Informimi dhe transparencja mbi punët e Bashkisë Tiranë




*Grafiku 5. Shërbimet sociale*




*Grafiku 6. Infrastruktura në institucionet e sistemit paraarsimor dhe arsimor*



*Grafiku 7. Investimet në infrastrukturë*




*Grafiku 8. Shërbimi i furnizimit me ujë*







*Grafiku 9. Trafiku dhe lëvizshmëria*




*Grafiku 10. Parkimet publike*




*Grafiku 11. Transporti urban*




*Grafiku 12. Menaxhimi i mbetjeve urbane*




*Grafiku 13. Pastrimi i hapësirave publike*




*Grafiku 14. Hapësirat rekreative dhe këndet e lojrave*




*Grafiku 15. Bashkëpronësia*




*Grafiku 16. Tregjet ushqimore*




*Grafiku 17. Promovimi i qytetit*




*Grafiku 18. Programet e rindërtimit pas 2 tërmeteve të vitit 2019*




Grafiku 19. Menaxhimi i situatës Covid-19




Grafiku 20. Mbrojtja e territorit



*Grafiku 21. Lirimi i hapsirave dhe qetësia publike*



*Grafiku 22. Ndriçimi publik*



# I. ANEKS 1 - PYETËSORI I SONDAZHIT



DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE JASHTË  
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT  
SEKTORI I OPINIONEVE QYTETARE

Nr. pyetësori \_\_\_\_\_

Dt: \_\_\_\_/\_\_\_\_/2020

## PERCEPTIMI QYTETAR PËR PUNËN E BASHKISË SË TIRANËS GJATË VITIT TË FUNDIT 2019-2020

### SEKSIONI I: Demografia

Nj. Administrative	Gjinia		Grup-mosha					mbi 65
	F	M	18-25	26-35	36-45	46-55	56-65	

### SEKSIONI II: Pyetjet - Vlerësoni punën dhe veprimtarinë e Bashkisë së Tiranës sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Veprimtaria	Vlerësimi	Aspak mirë	Jo mirë	Mesatar	Mirë	Shumë mirë	Pa përgjigje
1.	<b>Informimi &amp; transparenca mbi punën e BT</b> (shërbimi i sporteve të BT dhe Nj.A, konsultimet publike, transparenca dhe informimi mbi veprimtarinë në stenda/ueb tirana.al/ rrjete sociale)							
2.	<b>Shërbimet sociale</b> (programe e strehimit si kredi të buta, bonuse qeraje, qendra/menca sociale, nxitje e punësimit, bursa etj.)							
3.	<b>Infrastruktura në institucionet e sistemit paraarsimor dhe arsimor</b> (ndërtime dhe ndërhyrje në çerdhe/kopshte/shkolla)							
4.	<b>Investimet në infrastrukturë</b> (zgjerimi i trotuareve dhe shtimi i korsive të dedikuara, asfaltime, mirëmbajtje, rehabilitimi i blloqeve të banimit, Bulevardi i ri, projekti 100 lagjet etj.)							
5.	<b>Shërbimi i furnizimit me ujë</b> (zgjerimi i kapaciteteve të impiantit të Bovillës, mirëmbajtje/rinovime/zgjerime në rrjetin e UKT-së, përmirësimi i cilësisë të ujit të pijshëm, kamata 0 në pandemi etj.)							
6.	<b>Trafiku dhe lëvizshmëria</b> (sinjalistikë dhe siguri rrugore, menaxhim i trafikut, terminalët ndërqytetase, përdorimi i biçikletave etj.)							
7.	<b>Parkimet publike</b> (sheshi Italia, parkimi ish 7xhuxhat, parkimet sipas zonave, karta e rezidentit etj.)							
8.	<b>Transporti urban</b> (cilësia e shërbimit, vendqëndrimet etj.)							
9.	<b>Menaxhimi i mbetjeve urbane</b> (largimi i mbetjeve, dezinfektimi i vendgrumbullimeve, koshat për mbeturina etj.)							
10.	<b>Pastrimi i hapësirave publike</b> (pastrimi i shesheve, rrugëve etj.)							
11.	<b>Hapësirat rekreative dhe këndet e lojërave</b> (gjelbërimi, parqet, fushata për mbjelljen e pemëve, 50 kënde të reja, parku Rinia etj.)							
12.	<b>Bashkëpronësia</b> (fondi i komunitetit dhe restaurimi i fasadave, zgjedhja e administratorëve të godinave, heqja e depozitave të ujit etj.)							
13.	<b>Tregjet ushqimore</b> (mirëmbajtja dhe kontrolli në tregjet publike etj.)							
14.	<b>Promovimi i qytetit</b> (panaire, koncerte, dita pa makina, pastrojmë Tiranën, maratona, veprimtari kulturore, 100 vjet kryeqytet etj.)							
15.	<b>Programet e rindërtimit pas 2 tërmeteve 2019</b> (rindërtimi i banesave të dëmtuara, strehimi dhe bonusi i qerasë, ndihma në veshje dhe ushqime etj.)							
16.	<b>Menaxhimi i situatës së covid 19</b> (dezinfektim, higjienizim, pako ushqimore, adopto 1 gjysh/e, fushata informuese/ndërgjegjësuese etj.)							



17.	<b>Mbrojtja e territorit dhe ndërtimet pa leje</b> (pezullim ose prishja e ndërtimeve të kundraligjshme etj)					
18.	<b>Lirimi i hapësirave dhe qetësia publike</b> (lirimi i hapësirave të përbashkëta, trotuareve, shesheve, ushtrimi i kontrolleve në bare/restorante, furra buke, lavazhe, parandalimi i ndotjes së mjedisit dhe ndotjes akustike)					
19.	<b>Ndriçimi publik</b> (shtrirja e rrjetit të ndriçimit publik, mirëmbajtja etj.)					

**Shënim:** Ky pyetësor organizohet nga Bashkia e Tiranës dhe ka për qëllim vjeljen e opinionit mbi veprimtarinë e Bashkisë së Tiranës. Ky studim organizohet në përputhje me ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”; ligjin nr. 120/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar”, miratuar në datën 18.9.2014; Ligji nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Ju falënderojmë për kohën që i kushtuat plotësimin të këtij pyetësori dhe për mendimet që ndatë me ne, me vlerë për ofrimin e ty.

## II. ANEKS 2 – NUMRI I PYETËSORËVE PËR SECILËN NJËSI DHE LAGJE

Nj.A/Lagje	Nr.Pyetësorë
Nj.A.Nr.1	45
Nj.A.Nr.2	56
Nj.A.Nr.3	50
Nj.A.Nr.4	34
Nj.A.Nr.5	68
Nj.A.Nr.6	27
Nj.A.Nr.7	65
Nj.A.Nr.8	53
Nj.A.Nr.9	61
Nj.A.Nr.10	45
Nj.A.Nr.11	39
Lagje12	15
Lagje 13	20
Lagje 14	16
<b>Total</b>	<b>594</b>

## III. ANEKS 3 - LITERATURA/ LEGJISLACIONI I PËRDORUR

1. Ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
2. Ligjin 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
3. Ligji 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;